

Njoftim për përqendrim me të cilin AEKUH38 GmbH, Munih, Gjermani do të fitojë kontroll të vetëm mbi SABIC EUROPE B.V., Sittard, Holandë

(Lënda nr. 08-112/2026)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 15.07.2026, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin AEKUH38 GmbH, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me adresë afariste në Gabrielenstraße 9, 80636 Munih, Gjermani, synon të fitojë kontroll të vetëm mbi SABIC EUROPE B.V., shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, me seli të regjistruar në Sittard, Holandë.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe veprimtaritë e tyre afariste:

AEKUH38 GmbH është shoqëri e varur në pronësi të plotë të AEQUITA SE & Co. KGaA dhe vepron si shoqëri e saj për qëllime të veçanta (SPV).

Veprimtaria afariste e AEQUITA SE & Co. KGaA konsistojnë në investime në situata të veçanta, siç janë ndarjet e grupeve, suksesionet dhe situatat e ristrukturimit.

Transaksioni ka të bëjë me prodhimin dhe furnizimin me olefina, poliolefina dhe komponime.

AEKUH38 GmbH nuk është i pranishëm në tregjet relevante në Republikën e Maqedonisë së Veriut, as nëpërmjet pranisë së korporatave dhe as nëpërmjet importit të produkteve relevante.

SABIC EUROPE B.V. është shoqëri bijë në pronësi të plotë të SABIC International Holdings B.V.. SABIC International Holdings B.V. është shoqëri e varur në pronësi të plotë të Saudi Basic Industries Corporation ("**SABIC**"), kompani globale për prodhimin e kimikateve me seli në Arabinë Saudite.

SABIC EUROPE B.V. është aktive në tregun relevant në Republikën e Maqedonisë së Veriut nëpërmjet importit të poliolefinave në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar lidhur me këtë çështje mbetet i rezervuar.

Komisioni i fton palët e treta të interesuara që t'i dorëzojnë vërejtjet dhe mendimet e tyre lidhur me këtë përqendrim Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. „Shën Kirili dhe Metodi“ nr. 54, Shkup, ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk, dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision brenda afatit prej 10 ditësh nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

17.07.2026

Shkup